



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2024/0901

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga UD Kryetari i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (LPP) në përbërje nga Kimete Gashi duke vendosur sipas ankesës së Operatorit Ekonomik (OE) K.S. Dukagjini SH.A., kundër Vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit të K.K. SKENDERAJ në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK) lidhur me aktivitetin e prokurimit 048 - Sigurimi i Automjeteve Zyrtare në institucionet e Komunës së Skenderajt me numër të prokurimit 643-24-6800-2-2-1, me 14/11/2024, mori:

Vendim

1. **Aprovohet**, si e bazuar ankesa e OE K.S. Dukagjini SH.A. me nr. 2024/0901 , e datës 24/09/2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit 048 - Sigurimi i Automjeteve Zyrtare në institucionet e Komunës së Skenderajt me numër të prokurimit 643-24-6800-2-2-1 inicuar nga AK - KK Skenderaj

2. **Anulohet** Njoftimi mbi Vendimin i Autoritetit Kontraktues ndërsa aktiviteti i prokurimit si në pikën 1 të dispozitivit kthehet në **rivlerësim**

3. **Detyrohet** Autoriteti Kontraktues për zbatimin e këtij vendimi si dhe brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të vendimit të dërgoj në OSHP njoftimin lidhur me veprimet që ndërmerren për zbatimin e tij, të gjitha këto nën paralajmërimin se në rast të moszbatimit të këtij vendimi, OSHP do të ndërmerr masat kundër Autoritetit Kontraktues në përputhje me nenin 131 të LPP.

4. **Lejohet** kthimi i tarifave të ankesave në shumat e deponuara ashtu që obligohen operatorët ekonomik ankues që brenda afatit prej gjashtëdhjetë (60) ditëve pas pranimit të këtij vendimi të parashtrajnë secili për vete kërkesë për kthimin e tarifës në përputhje me nenin 31 par. 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, nën paralajmërimin që nëse nuk parashtrohet kërkesa brenda afatit, do të bëhet konfiskimi i depozitës dhe të gjitha mjetet e deponuara do të kalojnë në buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me04.07.2024,K.K. Skenderaj në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit.

Ndërsa me datën 06.09.2024 ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues ku ka shpërblyer me kontrate OE "Scardian J.S.C ”.

Ky aktivitet i prokurimit është zhvilluar me procedurë të hapur me llojin e kontratës shërbim me vlerë të parashikuar të kontratës 36,000.00 €

Me 09.09.2024, OE K.S. Dukagjini SH.A., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër vendimit të lartcekur të AK. Më 16.09.2024 Autoriteti Kontraktues ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim.

Me 24.09.2024, OSHP ka pranuar ankesën nga OE K.S. Dukagjini SH.A., me numër protokolli 2024/0901 lidhur me aktivitetin e prokurimit048 - Sigurimi i Automjeteve Zyrtare në institucionet e Komunës së Skenderajt me numër të prokurimit 643-24-6800-2-2-1.

-Mbi fazën e shqyrtimit paraprak-

Paneli Shqyrtues ka konstatuar se ankesa i përmban të gjitha elementet e përcaktuara përmes nenit 111 të LPP dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 109 paragrafin 1 të LPP pas procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve në kuptim të nenit 108/A të LPP, nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë Paneli Shqyrtues ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë ankesë sipas nenit 105 të LPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e ankesës në mënyrë meritore.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankues K.S. Dukagjini SH.A., janë parashtruar si në vijim:

Pretendimi i parë: “Kompania e Sigurimeve Dukagjini Sh.A si Operator Ekonomik pjesëmarrës në tenderin me numër prokurimi 643-24-6800-2-2-1, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: 048 - Sigurimi i Automjeteve Zyrtare në institucionet e Komunës së Skenderajt, me datë 25.07.2024 ka bërë hapjen e ofertave me ç’rast Kompania e Sigurimeve Scardian ka dalur si kompania më e lirë. Si Operator Ekonomik, duke ditur që në bazë të Ligjeve dhe Rregulloreve të BQK-së, tarifat për sigurimin e veturave janë të njëjta , atëherë kemi kërkuar qasje në dokumentet e tenderit në fjalë sipas afateve të parapara ligjore. Me të marr dosjet e kompanive pjesëmarrse kemi vërejtur që Kompania më e lirë bazuar në procesverbalin e hapjes të datës 25.07.2024 ka bërë shkelje të tarifave të BQK-së, dhe po ashtu nuk ka respektuar kërkesën e tenderit sipas paramases së kërkuar nga Autoritetit Kontraktues.Shkeljet e bëra nga Operatori Ekonomik Scardian i cili ka qenë më i lirë janë si më poshtë: 1. Tek pozicioni nr. 12 Ford D në dosje të tenderit është kërkuar edhe TPL+ ndërsa operatori ekonomik fare nuk ka ofertuar për TPL+ mirëpo ka ofertuar vetëm për TPL. (Bashkangjitur 1.Dosja e Tenderit dhe 2. Paramasa) 2.Tek pozicioni nr. 19. Mercedes Benz operatori ekonomik ka ofertuar me kubikazh ndërsa është dashur të oferton me peshe bartëse pasi që automjetet bartëse sipas ligjit regjistrohen me peshe bartëse dhe jo me kubikazh. Prandaj këtu Operatori Ekonomik ka bërë shkelje të tarifave të

Bankës Qendrore të Kosovës (BQK). (Bashkangjitur 3. Polica e Sigurimit e nxjerr prej sistemit Insurex i cili është i aprovuar dhe përdoret nga të gjitha kompanitë e licencuara në Kosovë, 4. Tarifat e Kompanive të Sigurimit të aprovuara nga Banka Qëndrore e Kosovës) 3. Tek pozicioni nr. 40. Mercedes Benz operatori ekonomik ka ofertuar me kubikazh ndërsa është dashur të oferton me peshe bartëse pasi që automjetet bartëse sipas ligjit regjistrohen me peshe bartëse dhe jo me kubikazh. (Bashkangjitur 5. Polica e Sigurimit e nxjerr prej sistemit Insurex i cili është i aprovuar dhe përdoret nga të gjitha kompanitë e licencuara në Kosovë) Andaj duke i parë këto parregullsi, ne si operator ekonomik pjesëmarrës ne tenderin në fjalë menjëherë kemi bërë Kërkesë për Rishqyrtim ku dhe me datë 09.09.2024 e kemi dorëzuar në platëformën E-prokurimi së bashku me faktet dhe argumentet e gjetura në këtë tender. (Bashkangjitur 6. Kërkesa për Rishqyrtim) Me datë 16.09.2024 marrim përgjigje ndaj kërkesës tonë për Rishqyrtim ku Refuzohet si e Pabazuar kërkesa jonë me arsyetimin që të gjitha informatat kane qene te njejta per te gjithë Operatorët Ekonomik, ashtu siç kane qene te detajuara tek Përshkrimi i çmimeve, andaj edhe OE ne baze te dhënave të ofruara në paramase (Përshkrimi i Çmimeve) kane plotësuar çmimet e tyre. (Bashkangjitur 7. Përgjigje ndaj kërkesës për Rishqyrtim) Ky vendim i autoritetit kontraktues është i mangët, dhe lë për t'u kuptuar që nuk është shqyrtuar fare kërkesa jonë, dhe sipas ligjit për procedurën e përgjithshme administrative, ky vendim, në mungesë të arsyesimit sipas ligjit konsiderohet i barabartë me mungesën e tij (të vendimit). Ky vendim, i atakuar, nuk mori fare për bazë tërë procedurat e tenderimit, dhe shkeljet siç i kemi paraqitur, Ankuesi paraqet para OSHP-së se shkeljet janë të rënda, dhe atë është shkelur : Ligji 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës , i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04L/237, Ligjin Nr.05/L-068 dhe Ligjin Nr.05L-092 respektivisht Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve pika 4 (citotjmë “ Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmjja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit ne fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve”). Këtu kemi të bëjmë me shkeljen e parë nga Autoriteti Kontraktues pasi ka shpallur fitues Operatorin Ekonomik i cili dorëzimin e ofertës e ka bërë pa llogaritur fare çmimin e TPL + për pozicionin nr. 12 Ford D , copë 2 viti 2011 , mirëpo ka ofertuar vetëm çmimin e TPL ndërsa sipas Dosjes së tenderit tek ANEKSI 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME respektivisht tek pozicioni nr. 12 Ford D kërkohet edhe TPL+ për këto 2 vetura, prandaj edhe Operatori ekonomik ka dal me çmim me te lirë tek ky pozicion. Tek pozicioni nr. 19 Mercedes Benz operatori ekonomik ka ofertuar me kubikazh ndërsa është dashur të oferton me peshe bartëse pasi që automjetet bartëse sipas Ligjit regjistrohen me peshe bartëse dhe jo me kubikazh, pra janë shkelur tarifrat e aprovuara të Bankës Qendrore të Kosovës. Tek pozicioni nr. 40 Mercedes Benz operatori ekonomik ka ofertuar me kubikazh ndërsa është dashur të oferton me peshe bartëse pasi që automjetet bartëse sipas ligjit regjistrohen me peshe bartëse dhe jo me kubikazh, pra janë shkelur tarifrat e aprovuara të Bankës Qendrore të Kosovës. Sipas Nenit te cekur më lartë Autoriteti Kontraktues është dashur që Operatorin Ekonomik ta konsideroj si të pa përgjegjshëm pasi tenderi i tyre nuk ka qene në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe dosjes se tenderit (Dosja e tenderit pika 3. Specifikimet teknike të detyrueshme 3.1 Shërbimet duhet të jenë në pajtim të plotë me specifikimet teknike të parashtruara në këtë Dosje të Tenderit, shih Aneksin 1, dhe në

përputhshmëri në të gjitha aspektet me vizatimet, sasitë, modelet mostrat, matjet dhe udhëzimet tjera 3.2 Cilido specifikim që nuk është në përputhshmëri me specifikimet teknike do të diskualifikoj tenderin). Pasi edhe nëse shpallet fitues operator ekonomik, i njëjti nuk mundet që pozicionin nr. 19 dhe 40 ti regjistrojë si automjete të udhëtareve pasi nuk pranohen prej QRA (Qendrës së regjistrimit të automjeteve) pasi janë automjete me peshë bartëse. Neni 60 Kriteret për Dhënie e Kontratës pika 1 (citojmë “ Autoriteti kontraktues do t’ia jap kontratën publike operatorit ekonomik që ka dorëzuar ose: 1.1 tenderin e përgjegjshëm me çmimin më të ulët;) Edhe këtu shihet qartë se Autoriteti Kontraktues nuk ka respektuar këtë nen pasi ka shpallur fitues Operatorin Ekonomik i cili nuk ka qene i përgjegjshëm pasi ka shkelur dispozitat ligjore duke mos aplikuar tarifat e sakta sipas legjisllacioneve ne fuqi dhe për një pozicion nuk ka aplikuar fare (pozicionin nr. 12 TPL +). Rregullorja Nr.001_2022 Për Prokurim Publik Neni 19 Specifikimet Teknike (citojmë “pika 19.11 Specifikimet teknike janë kërkesa obligative, të cilat të gjithë tenderët duhet t’i përmbushin në mënyrë që të konsiderohen tenderë të përgjegjshëm). Edhe këtu shihet qartë se Autoriteti kontraktues nuk ka marr për bazë fare këtë Nen dhe ka shpallur fitues një operator ekonomik i cili nuk ka përmbush të gjitha specifikimet e sakta teknike siç është kërkuar ne dosje te tenderit, pra duke mos kalkuluar çmimin edhe për TPL+ për 2 vetura sipas kërkesës se dosjes se tenderit saktësisht tek pozicioni nr. 12 Ford D ku është kërkuar çmimi për TPL dhe TPL+ , tek pozicioni nr. 19 Mercedes Benz operatori ekonomik ka ofertuar me kubikazh ndërsa është dashur të oferton me peshe bartëse pasi që automjetet bartëse sipas ligjit regjistrohen me peshe bartëse dhe jo me kubikazh, si dhe tek pozicioni nr. 40 Mercedes Benz operatori ekonomik ka ofertuar me kubikazh ndërsa është dashur të oferton me peshe bartëse pasi që automjetet bartëse sipas ligjit regjistrohen me peshe bartëse dhe jo me kubikazh. Neni 40 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve (citojmë “ 40.1 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve bëhet në pajtueshmëri me parimet themelore të përcaktuara me LPP. 40.2 Tenderët e pranuar me kohë të paraqitur nga tenderuesit do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit dhe kontrata do ti jepet tenderuesit që ka renditjen më të lartë. Kështu, autoritetet kontraktuese nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa të përcaktuara paraprakisht, kritere ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve. Kjo gjithashtu vlen, kur autoritetet kontraktuese ri- vlerësojnë procedurën e prokurimit në mënyrë që të korrigojnë vendime të gabueshme dhe kur një ri-vlerësim bëhet si rezultat i një vendimi të OSHP-së, përfshirë një urdhër për ri-vlerësim. Një vendim për ri-vlerësim të përzgjedhjes së ofertuesve ose dhënies së kontratës nuk nënkupton një ndryshim në rezultatin fillestar). Autoriteti Kontraktues gjatë vlerësimit të tenderëve nuk ka respektuar pikën 40.2 ku ishte dashur që tenderët e Operatoreve Ekonomik pjesëmarrës të vlerësohen se a janë në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit por duke e anashkaluar këtë nen shpallin fitues një operator ekonomik i cili nuk ka respektuar kriteret e përcaktuara ne dosje te tenderit. (Saktësisht nuk janë marrë për bazë pozicionet nr. 12, nr. 19 dhe nr. 40 të cekura më lartë ku operatori ekonomik ka bërë shkelje dhe ka ofertuar me çmim qëllimisht më të lirë) . Rregulla dhe udhëzuesi operativ për prokurim publik 41. Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve (citojmë “ 41.6.Të qenët “në pajtueshmëri” nga aspekti administrativ dhe teknik duhet të kuptohet si përmbushje e kërkesave dhe e specifikimeve administrative dhe teknike të parashtruara në dosje të tenderit duke mos u larguar substancialisht nga ato dhe duke mos u bashkangjitur atyre kufizime dhe pikën 47.17 Si një masë paraprake, autoriteti kontraktues duhet të kontrollojë se tenderët janë në përputhje me kërkesat formale të dosjes së tenderit, me fjalë të tjera përgjegjshmëria në një kuptim formal. Një tender konsiderohet të jetë formalisht i përgjegjshëm, në qoftë se përmbush të gjitha kërkesat formale në dosjen e tenderit, pa devijuar

substancialisht nga apo pa i bashkangjitur atyre kufizime. Këto kërkesa formale mund të jenë në lidhje me formularin e tenderit të plotësuar mirë, sigurimin e tenderit, etj. Po ashtu pikën 47.18 Autoriteti kontraktues do të vlerësojë nëse tenderët që kanë kaluar testet e nenit 47.17 të këtyre rregullave dhe këtij Udhëzimi Operativ janë në pajtueshmëri në kushtet teknike, përshkrimin dhe specifikimet e dosjes së tenderit. Një tender, si rregull kryesor, konsiderohet të jetë i përgjegjshëm vetëm në qoftë se është në përputhje me specifikimet teknike të parashtruara në dosjen e tenderit). Siç parashihet edhe në pikat më lartë pra 41.6, 47.17 dhe 47.18 Autoriteti kontraktues nuk ka marr këto pika fare për bazë dhe ka shpall fitues operatorin ekonomik i cili nuk ka përmbushur kërkesat dhe specifikimet teknike administrative të parashtruara në dosje tenderi të cilat i kemi cekur më lartë. Dhe duke parë që ky tender ka pasur parregullsi nga AK, dhe që kërkesa për rishqyrtim nuk është trajtuar fare, bazuar në vendimin e atakuar këtu, kërkojmë nga OSHP që të vendos me një vendim bazuar në Ligjet, rregulloret edhe udhëzimet e aprovuara në Kosovë. Të gjitha këto si më lartë janë paraqitur në kërkesën për rishqyrtim, andaj me qëllim po i paraqesim edhe këtu, për të bindur OSHP-në se sa bazë ligjore ka pasur autoriteti për ta shqyrtuar seriozisht kërkesën para se të merrte një vendim. Marrja e një vendimi të padrejtë, në 5 | P a g e kundërshtim me vet ligjin, dhe rregulloret për prokurimin publik, siç e kemi cekur më lartë, dhe në kundërshtim edhe me Ligjin për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i ka shkaktuar, dhe vazhdon të shkaktojë ankuesit dëme në emër të fitimit të humbur po ashtu edhe uljen e Autoritetit në tregun e Sigurimeve. Vendimi i atakuar këtu, përveç që ka shkelur dispozitat ligjore të prokurimit publik në Kosovë, ka injoruar në tërësi kërkesat e operatorit/ankuesit këtu. Sepse, sipas ligjit, autoriteti është dashur që me kujdes ta shqyrtojë kërkesën, dhe të vendos bazuar në kërkesat e ankuesit, e jo të vendos shkel e shko. Pra, me ligj kërkohet që “Arsyetimi i një akti administrativ me shkrim i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrative dhe akti duhet të përmbajë, ndër të tjera, shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi, shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave, bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret, shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve.”

Duke u referuar kërkesave si më sipër OE K.S. Dukagjini SH.A., konsideron se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me neni 50 pika 4, 60 pika 1 të LPP-së. Si dhe neni 19, 40, 41 të Rrpp-së. Kërkojmë nga OSHP, bazuar në ligj, dhe të aprovojë ankesën si të bazuar, e të kthejë lëndën në ri tenderim, ashtu që të jemi të trajtuar barabartë të gjithë ofertuesit, dhe pa diskriminim.

Përgjigje e AK në kërkesën për rishqyrtim: “Operatori Ekonomik “K.S. Dukagjini SH.A., ka parashtruar kërkesën për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: ”048 - Sigurimi i Automjeteve Zyrtare në institucionet e Komunë së Skenderajt” me nr. të Prok: 643-24-6800-2-2-1, Autoriteti Kontraktues, gjatë shqyrtimit, analizimit, si dhe shoshitjes së argumenteve rreth pretendimeve ankimore sqaron se: Të gjitha pretendimet tuaja në lidhje me shkeljet ligjore të neneve të poshtë cekura janë të pa qëndrueshme; Ne ju sqarojmë se të gjitha informatat kanë qenë të njëjta për të gjithë Operatorët Ekonomik, ashtu siç kanë qenë të detajuara tek Përshkrimi i Çmimeve, andaj edhe OE në bazë të dhënave të ofruara në paramasë (Përshkrimi i Çmimeve) kanë plotësuar çmimet e tyre. Si rrjedhojë e kësaj pretendimet e juaja ankimore janë të pabazuara. Gjithashtu, oferta e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë Kompania e Sigurimeve " SCARDIAN " J.S.C. është në harmoni të plotë me kërkesat e Autoritetit Kontraktues të specifikuar në Njoftimin për Kontratë dhe Dosjen e Tenderit. Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.”

- Vlerësimi dhe administrimi i provave -

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Organi Shqyrtues i Prokurimit me datë 27/09/2024 ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0901/2024, ndërsa me datë 04/10/2024 është dorëzuar raporti i ekspertit shqyrtues me nr. 2024/0901 me rekomandimet si në vijim: “Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim”.

Konstatimet e ekspertit shqyrtues lidhur me pretendimet ankimore-

Konstatimi i parë: “Eksperti sqaron se pikënisja e problemit ka të bëjë me atë se OE ankues pretendon se OE i rekomanduar për kontratë ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme sepse për disa pozicione nuk ka aplikuar çmimet sipas tarifave të BQK-së, për faktin se për disa pozicione nuk ka aplikuar fare TPL+ kurse në disa pozicione ka ofertuar vetëm me kubikazh dhe jo peshë bartëse siç kërkohet, bazuar në analizën e fakteve/dëshmimeve të dokumentuara në platformën elektronike E-prokurimi, AK gjatë përgatitjes së dosjes së tenderit më saktësisht tek përshkrimi i çmimeve kishte paraparë që për pozicionin 12 FORD D të bëhet edhe TPL+ për dy vite. Më tej, pala në ankesë e kundërshton, çmimin e ofertuar nga OE i rekomanduar për kontratë edhe për pozicionet 19, 40 tek përshkrimi i çmimit (Mercedes Benz), për faktin se operatori ekonomik ka ofertuar me kubikazh të motorit, ndërsa është dashur të oferton me peshe bartëse pasi që automjetet bartëse sipas ligjit regjistrohen me peshë bartëse dhe jo me kubikazh. Prandaj këtu Operatori Ekonomik ka bërë shkelje të tarifave të Bankës Qëndrore të Kosovës (BQK). (Bashkangjitur 3.Polica e Sigurimit e nxjerr prej sistemit Insurex i cili është i aprovuar dhe perdoret nga të gjitha kompanitë e licencuara në Kosovë, 4. Tarifat e Kompanive të Sigurimit të aprovuara nga Banka Qendrore e Kosovës). Po ashtu OE ankues e kundërshton e pozicionin nr. 28 Autobus nuk janë llogaritur ulëset e autobusit saktësisht duke bërë prap shkelje të tarifave të BQK. Pas shqyrtimit të provave shkresore konstatojmë se pozicionet e kontestuara nga OE ankues – sa i për ketë llogaritjes së çmimeve nga ana e OE të rekomanduar për kontratë nuk janë në përputhje me tarifat e BQK-së pasi që OE i rekomanduar për kontratë për pozicionin 12 FORD D ka kalkuluar vetë çmimin e TPL në vlerë prej 156.59€ me TVSh apo 313.78 € me TVSh për dy vite. Bazuar në përshkrimin e çmimit të publikuar nga AK për pozicionin 12 FORD D është kërkuar edhe TPL+ për dy vite, andaj OE i rekomanduar për kontratë është dashur që të kalkuloj edhe TPL+ në vlerë prej 47,07€ me TVSh për një vit apo 94.14€ për dy vite siç është kërkuar nga ana e AK-së. Andaj sipas tarifës së BQK-së, vlera për pozicion 12 FORD D për TPL dhe TPL+ për një vit me TVSh është dashur të jetë 203.96€ apo 407.92€ e jo 313.78 siç ka ofertuar OE i rekomanduar për kontratë. Dilema tjetër e ngritura nga OE ankues është se edhe pozicionet 19 dhe 40 tek përshkrimi i çmimit janë kalkuluar në kundërshtim me tarifat e BQK-së, pasi që për automjete bartëse sipas ligjit duhet të regjistrohen me peshë partëse dhe jo me kubikazh të motorrit. Vlerësojmë se bazuar në tarifat e BQK-së për automjete bartëse prej 3-5 tonë të përfshira në grupin tarifor II Automjete Kargo- Kamioneta, tarifat janë 359.90€ me TVSh, në këtë kategori të tarifës hyn pozicionet e kundërshtuara nga ana e OE ankues. OE i rekomanduar për pozicionin 19 dhe 40 ka aplikuar tarifat e parapara në grupin tarifor 1 apo automjete për pasagjerë, duke e kalkuluar çmimin e paraparë për mbi deri 2701 ton apo vlerën e tarifës 313.79 € me TVSh, e që sipas tarifave të BQK-se, nuk aplikohen për automjete bartëse. Si përfundim, ekspertin shqyrtues, po ashtu sqaron se mbetet në përgjegjësi dhe diskrecion të Autoritetit kontraktues, respektivisht ZPP-së që vlerësimi i ofertave, të bëhet në përputhje të plotë me nenin 59 paragrafi 4 dhe me nenin 56 paragrafi 3 i LPP-së, nenin 72 paragrafi 1 i LPP-së dhe tarifat e BQK-së në atë mënyrë që lejojnë trajtim të barabartë më mes të operatorëve

ekonomik dhe të arrihet qëllimi i LPP-se dhe vlera për parën. Prandaj, në bazë të konstatimeve të mësipërme vlerësojmë se pretendimet e palës në ankesë në këtë pikë janë të qëndrueshme.”

Paneli konstatoi se nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP dhe njëherësh analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe veprimet e palëve dhe konsideroi se nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtrësat e palëve dhe veprimet e tyre, përbëjnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritator sikurse parashihet me paragrafin 1, të nenit 24 të Rregullores së Punës së OSHP, dhe se nuk ka nevojë të kërkohen nga autoriteti kontraktues dhe/ose parashtrësi i ankesës që të sigurojë informata dhe/ose shpjegime shtesë, në kuptim të paragrafit 3, të nenit 116 të LPP.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues -

Paneli shqyrtues pas vlerësimit dhe administrimit të provave sipas ankesës së dorëzuar sqaron se konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues për këto dy lëndë mund të konfirmohen vetëm pjesërisht përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit dhe janë të mbështetura edhe në dispozitat përkatëse të LPP dhe RRPP. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin raportit të ekspertit shqyrtues.

Vlen të theksohet fakti se për Panelin Shqyrtues, konstatimet dhe rekomandimet e ekspertëve shqyrtues nuk janë të detyrueshme, por shërbejnë vetëm si një provë në mesin e të gjitha provave tjera që vlerëson në secilën lëndë veç e veç. Paneli Shqyrtues vendos në mënyrë të pavarur, objektive dhe me kujdesin e duhur profesional duke mbrojtur gjithmonë interesin e publikut përmes LPP dhe legjislacionit sekondar në fuqi për prokurimin publik.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit dhe konsideron se Autoriteti Kontraktues gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të ofertave nuk ka vepruar në harmoni me nenin 59 dhe 72 të LPP.

Paneli shqyrtues në mënyrë të pavarur dhe objektive, me ndërgjegje dhe kujdes profesional ka vlerësuar të gjitha provat e rastit. Në këtë mënyrë është gjetur se Autoriteti Kontraktues nuk ka vepruar në përputhje me dispozitat ligjore për prokurimin publik dhe kërkesat e dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit 048 - Sigurimi i Automjeteve Zyrtare në institucionet e Komunës së Skenderajt me numër të prokurimit 643-24-6800-2-2-1. Paneli shqyrtues vlerëson se eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive pretendimet e operatorit ekonomik ankues K.S. Dukagjini SH.A., dhe se Argumentimi në raportin e ekspertit është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht në dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat kanë ofertuar tenderuesit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankues i ka falur besimin e plotë raportit të ekspertit. Në këtë mënyrë është gjetur se pretendimet e operatorit ekonomik ankues K.S. Dukagjini SH.A. janë të bazuara.

Paneli Shqyrtues thekson faktin se është përgjegjësi ekskluzive e Autoritetit Kontraktues për të bërë ekzaminimin, krahasimin dhe vlerësimin e ofertave por edhe dhënien e kontratave të

prokurimit publik. Paneli Shqyrtues dhe aq më pak ekspertët shqyrtues nuk mund të lëshohen në vlerësimin e ofertave por vetëm gjykojnë nëse veprimet e AK janë në përputhje ose jo me dispozitat në fuqi të LPP dhe legjislacionit sekondar për prokurimin publik.

Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit Ekonomik aprovohet si e bazuar. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull 048 - Sigurimi i Automjeteve Zyrtare në institucionet e Komunës së Skenderajt me numër të prokurimit 643-24-6800-2-2-1, të anulohet njoftimi për dhënie të kontratës dhe lënda të kthehet në rivlerësim. Paneli Shqyrtues duke marrë parasysh përshkrimin dhe faktet e lartë përmendura dhe pas shqyrtimit të lëndës, ankesën e operatorit ekonomik ankues, analizës konkrete dhe dokumentacionit të lëndës ,ankesën e operatorit e sheh si te bazuar, duke rekomanduar që aktiviteti i prokurimit me 048 - Sigurimi i Automjeteve Zyrtare në institucionet e Komunës së Skenderajt me numër të prokurimit 643-24-6800-2-2-1 që lënda të kthehet në rivlerësim AK të veproj në raport me dispozitat ligjore të LPP-së dhe kërkesat e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë.

Paneli Shqyrtueska vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës.

Paneli Shqyrtues kërkon nga Autoriteti Kontraktues që të jetë i vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik duke vepruar në përputhje të plotë me LPP dhe legjislacion tjetër në fuqi për prokurimin publik si dhe të veproj në harmoni me të gjeturat e këtij vendimi. Në të kundërtën OSHP mund të inicoj procedurat disiplinore ndaj zyrtarëve të prokurimit.

Për pikën I, II dhe III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 dhe 31 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën IV të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 131 të LPP lidhur me nenin 29 paragrafin 3 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën V të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 31 paragrafin 4 dhe paragrafin 6 të Rregullores së Punës së OSHP lidhur me nenin 118 të LPP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Kimete Gashi

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - K.K. SKENDERAJ**
- **OE - K.S. Dukagjini SH.A.**
- Arkivës së OSHP-së: